



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 10, datë 28.05.2020

PËR

“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË ANEKSIN E, TË RREGULLORES NR. 47 DATË 26.10.2017 “PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 28/05/2020, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 62, të Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aneksin E, të Rregullores nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 12, 15, 110 dhe 115 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji nr.9918/2008*);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, (*Ligji nr.44/2015*);

3. VKM nr.141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” (*VKM nr.141/2017*);
4. Rregullore nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm” (*Rregullore nr.47/2017*);
5. Urdhër Nr.25, datë 21.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKCESK, “Udhëzim për Administrimin e portalit online për mbylljen e aksesit të faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme”;
6. Udhëzues për Proçedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt–Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aneksin E, të Rregullores nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”;
3. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit, të hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr.53, datë 27/04/2020 (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen dhe bazës ligjore të lartpërmendur,

V Ë R E N :

1. Në kushtet e përmbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji kuadër normues për komunikimet elektronike, AKEP ka miratuar Rregulloren nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”. Në pikën 9, të Aneksit E, të Rregullores nr.47/2017, është përcaktuar dhe detajuar efektivisht procedura që duhet të ndiqet në funksion të përmbushjes së kushtit të përgjithshëm për respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme apo të dëmshme, të parashikuar në germën e), të nenit 15, të Ligjit nr.9918/2008.
2. Sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren 47/2017 dhe Aneksin E të saj, AKEP vendoset në rolin e organit përgjegjës për përcjelljen e vendimeve me karakter shtrëngues të organeve publike të cilat kanë kompetencën ligjore për të shqyrtuar/trajtuar përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nga rrjetet e komunikimit elektronik, tek sipërmarrësit që ofrojnë të tilla shërbime.
3. Kjo dispozitë ka synuar përmirësimin e komunikimit të vendimeve të institucioneve kompetente për kufizimin e transmetimeve të paligjshme apo të dëmshme, përkatësisht, Autoritetit të Mediave Audiovizive, Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, Policisë gjyqësore apo organeve të ndjekjes penale, tek zbatuesit e tyre, përkatësisht sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (operatorët), që janë subjekte të Ligjit nr.9918/2008.

4. Në zbatim të përcaktimeve ligjore të dhëna më sipër, AKEP është përgjegjës në çdo rast organeve publike të cilat në shprehje të vullnetit të tyre dhe në ushtrim të kompetencave ligjore për shqyrtimin e përmbajtjeve të paligjshme apo të dëmshme, kanë kërkuar bllokimin e aksesit për rastet e verifikuara prej tyre si me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme. AKEP ka përcjellë me shkresë zyrtare çdo kërkesë të ardhur nga këto organe publike tek ofruesit e shërbimit internet (ISP).
5. Ndryshimet në kuadrin normativ përsa i përket respektimit të kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, adresojnë drejt një përditësimi të kësaj Rregulloreje dhe harmonizimit të saj me aktet ligjore e nënligjore.
6. Së pari, hyrja në fuqi datë 18.02.2020 e ligjit 92/2019 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH” të ndryshuar, dhe integrimi i tij në ligjin për komunikimet elektronike, ka përcaktuar qartë kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet AKEP dhe AMA, si dhe modalitetet nëpërmjet të cilave AKEP siguron zbatimin e vendimeve të organeve të AMA. Ndërhyrja në aktin rregullator, konsiderohet e nevojshme në raport me këto ndryshime ligjore dhe harmonizimit të tyre me Rregulloren 47/2017.
7. Së dyti, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 “Për krijimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” është krijuar Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK). Ky Autoritet, ndër të tjera ka për detyrë, ngritjen, administrimin dhe të mirëmbajtjen e sistemit unik/portalit online, për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, të cilat konstatohen si të tilla nga autoritetet publike dhe dërgohen zyrtarisht pranë këtij autoriteti, me qëllim bllokimin e aksesit në internet të tyre nga ISP-të.
8. Në kushtet kur AKCESK ka vënë në funksion sistemin unik/portalin online, të sipërpërmendur, procedura e përcaktuar në Aneksin E, të Rregullores nr.47/2017 lipset të harmonizohet me procedurën, modalitetet dhe protokollin e parashikuar për funksionimin këtij sistemi.
9. Në këtë kuptim, ndryshimet e propozuara në Rregullore përveç se janë rezultat i përditësimeve ligjore, synojnë të qartësojnë dhe të thjeshtojnë koordinimin midis organeve publike që mbartin detyrimin për të shqyrtuar ligjshmërinë e kontetit të faqeve online, dhe të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike për një trajtim sa më eficient të mbylljes së aksesit në internet të faqeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 110, të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i dokumentit të sipërcituar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit: “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aneksin E, të Rregullores nr.47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm””, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore, nga data 28.05.2020-28.06.2020.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr.53, datë 27.04.2020 të Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin TOPÇIU	Xhoana LILAJ



AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PËR NXJERRJEN NË KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT

PËR

**“DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË ANEKSIN E, TË RREGULLORES Nr.47,
DATË 26.10.2017, “PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË
PËRGJITHSHËM””**

- Pika 9 e Aneksit E, “Kushtet e përgjithshme për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të Rregullores nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, është:

9. Respektimi i kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme:

9.1 Për transmetimet e përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme mbi bazën e një vendimi të marrë nga organet kompetente të parashikuara në legjislacionin respektiv, zbatohen kufizime.

9.2 Sipërmarrësi/subjekti që ofron rrjetin dhe ose shërbimin/et e komunikimeve elektronike, ka detyrimin ligjor që të marrë masat e duhura juridike dhe teknike për zbatimin e kufizimit të kërkuar.

9.3 AKEP, me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësit, subjektit që ofron rrjetin dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik publik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje.

9.4 Me marrjen e kërkesës nga AKEP për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipërmarrësi është i detyruar të veprojë menjëherë për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit.

Pika 9 e Aneksit E “Kushtet e përgjithshme për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” të Rregullores nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, riformulohet dhe bëhet:

9. Respektimi i kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme:

9.1 Për shmangien dhe parandalimin e keqpërdorimit të shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik, zbatohen kufizime për bllokimin e aksesit përmes internetit, në përmbajtje të përcaktuara dhe të cilësuara të paligjshme apo të dëmshme nga legjislacioni specifik dhe mbi bazën e vendimeve/akteve administrative të hartuara në përputhje me nenet 98 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nga autoritetet dhe organet përgjegjëse në kuptim të të njëjtit legjislacion specifik.

9.2 Referuar nenit 12, pika 3 e Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar¹, AKEP duke iu përmbajtur me rigorozitet detyrave të përkufizuara dhe të kornizuara nga ky ligj², kujdeset në mënyrë të drejtpërdrejtë, për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s në lidhje me shmangien, parandalimin dhe kufizimin e përmbajtjeve të paligjshme apo të dëmshme në shërbimet e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

9.3 Në çdo rast, për zbatimin e kushtit për respektimin e kufizimeve të përmbajtjeve të paligjshme, sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të aksesit në internet, kanë detyrim ligjor³ që të ndjekin procedurën e përcaktuar më poshtë:

- a. Të regjistrohen në sistemin unik/portalin online, i cili administrohet dhe mirëmbahet nga Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike (AKCESK);
- b. Të aksesojnë sistemin unik/portalin online dhe, me marrjen e njoftimit, të realizojnë mbylljen e aksesit në internet të faqeve me përmbajtje të cilësuara të paligjshme ose të dëmshme nga organet përgjegjëse/autoritetet, sipas njoftimit zyrtar të këtyre të fundit, regjistruar në sistemin e portalit të AKCESK;
- c. Të marrin masat e duhura juridike dhe të gjejnë zgjidhjet e duhura teknike për zbatimin e kufizimit të aksesit në internet të faqeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme të përcaktuara si të tilla nga organet përgjegjëse/autoritetet publike;
- ç. Të konfirmojnë në portal mbylljen e aksesit në internet të faqeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme;

¹ Ndryshuar me Ligjin 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar ne Fletoren Zyrtare 11, datë 03.02.2020 dhe hyrë në fuqi në datën 18.02.2020.

² Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, t i ndryshuar, nenet 132 e në vijim.

³ Bazuar në VKM nr.141, datë 22.02.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, dhe aktet e dala në zbatim të tij.

d. Të ndjekin dhe të zbatojnë në vijimësi udhëzimet e AKCESK për funksionimin e sistemit, si dhe të zbatojnë detyrimet vendosura nga ky autoritet për sipërmarrësit lidhur me bllokimin e aksesit në internet për faqet me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, brenda afateve përkatëse. Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga aktet nënligjore të nxjerra nga AKCESK, përbën kundravajtje administrative dhe në këto raste zbatohet legjislacioni në fuqi.

9.4 Përfundimisht nga sa më sipër, referuar gërmasës rr), të nenit 8, të Ligjit nr.9918/2008, AKEP me marrje informacioni që ka të bëjë me cënime të mbrojtjes së interesave të vendit apo/dhe të sigurisë publike, si edhe gjatë gjendjes së luftës apo situatave të jashtëzakonshme sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore, ndërvepron në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme me sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike për marrjen e masave të duhura për respektimin e kufizimeve të përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme.

9.5 AKEP zbaton parashikimet ligjore të nenit 137, të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar dhe të nenit 11 të kësaj Rregullore, të cilat parashikojnë masën administrative gjobë për sipërmarrësit që nuk përmbushin detyrimet e mësipërme.